

REPUBLIKA E KOSOVËS

C.nr. 2946/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni për çështje civile, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Latif Xhemaili, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.M.nga P., rr. “N.G.”, objekti nr...., kati ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.T., avokat nga P., kundër të paditurës N.Z. dhe B.1 “B.2”, me seli në P., Zona Industriale, p.nr., lidhur me padinë Vërtetim pronësie, jashtë seancës, më dt.24.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M **-në bazë të pohimit-**

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit R.M.nga P..

II.VËRTETOHET se paditësi R.M.nga P., në bazë të kontratës bashkinvesticionale për ndërtimin e objektit banesor, nr...., e dt. 13.04.2001, e ka fituar të drejtën e pronësisë në palujatshmërinë-banesën që gjendet në P., rr. “N.G.”, Blloku ..., objekti nr...., banesa nr...., në katin ..., në sipërfaqe prej ...m², mbi ndërtim, ngastra kadastrale ..., e cila kontratë bazohet në kontratën themelore nr.... e dt.11.09.2000, që ka të bëjë me mbindërtimin e objekteve banesore në lagjen blloku ..., rr. “N.G.” në P..

III. DETYROHET N.Z. dhe B.1 “B.2” me seli në P., që paditësit t’ia pranoj të drejtën e pronësisë si në pikën II të këtij dispozitivi, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, me mundësi edhe të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. Obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Prishtinës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, paluajtshmërinë e përkthuar më lartë ta regjistron në emër të paditësit.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi R.M., me padinë e dt.01.12.2016, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura N.Z. dhe B.1 “B.2”, që ta aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që të vërtetohet se paditësi R.M.nga P., në bazë të punës së vlefshme juridike-kontratës bashkinvesticionale për ndërtimin e objektit banesor, nr...., e dt.13.04.2001, e lidhur në mes të bashkinvestuesve, kë këtë rast paditësit R.M.nga P. dhe të paditurës NZB “B.2”, me seli në P., është pronar i banesës në P., në lagjen Blloku ..., rr. “N.G.”, parcela kadastrale nr...., objekti nr...., banesa nr...., në katin e ..., në sipërfaqe prej ...m².

I njejtë, padisë së dt.01.12.2016 ia ka bashkangjitur: Kontratën investicionale për ndërtimin e objektit banesor me nr...., të dt.13.04.2011, të lidhur në mes të paditësit R.M.dhe të paditurit NZB “B.2”; Aktvendimin e lëshuar nga Departamenti i Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, me të cilin aprovet kërkesa 04 nr.351-148 e dt.16.02.2000, e investuesit Trupat Mbrojtës të Kosovës, Zona V nga P., për dhënien e lejës për ndërtimin e mbikulmeve dhe kulmeve të reja; Kontrata për mbindërtimin ..., e dt.11.09.2000, e lidhur në mes të

Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Zona V në P. dhe NZB “B.2” me seli në P.; Leja e ndërtimit e dt.19.06.2000, me nr..., e lëshuar nga UNMIK-u; Vërtetimin nr..., të dt.20.05.2011, më të cilin vërtetohet se R.M.nga P. i ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj NZB “B.2”, me seli në P..

Gjykata me aktvendimin e dt.30.11.2017, e ka detyruar të paditurën NZB “B.2” me seli në P., që në afat prej 15 ditësh ti paraqës gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar.

E paditura NZB “B.2” me seli në P., me parashtresën e dt.18.12.2017, njoftoi gjykatën se nuk është kundër padisë së ushtruar në këtë gjykatë nga pala paditëse, pasi që i njehti me kohë i ka përmbushur të gjitha obligimet financiare që rrjedhin nga kontrata nr.44 e dt.13.04.2001, prandaj padinë C.nr.2946/16, të datës 01.12.2016, nuk e kundërshtojnë, por e pranojnë në tërësi si të bazuar. E njëjta i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit R.M.ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Pas pohimit të padisë dhe kërkesëpadisë nga ana e të paditurës dhe pasi që gjykata konstatoi se nuk bëhet fjalë për kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht, siç është përcaktuar me nenin 3 par.3 të LPK-së- Ligji nr. 03-L/066, si dhe duke u bazuar në atë që në mes të palëve nuk kishte asgjë kontestuese për sa i përket objektit të padisë dhe kërkesëpadisë, gjykata në pajtim me nenin 148 par. 1 të LPK-se, mori aktgjykim në bazë të pohimit dhe vendosi si në dispozitiv.

Konform 450 të LPK-së, gjykata ka vendosur që secila palë ti barte shpenzimet e veta procedurale, pasi që asnjëra nga palët nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr. 2946/16, më datë 24.10.2018

Gjyqtari,
Latif Xhemali

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.